

**QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË-
QKSS**

**Raporti i Auditimit nga Auditori i Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më
31 Dhjetor 2021**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1 - 2
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 12

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë- QKSS

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të organizatës jo-qeveritare Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për periudhat që kanë përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të organizatës- QKSS paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për periudhat që kanë përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM), dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Shyqiri Bytyqi
Auditor Ligjor
Prishtinë, Kosovë
13 Qeshor 2022



QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS
Pasqyra e pozitës financiar më 31 Dhjetor 2021

	Shënimi	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	193,613	161,534
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		193,613	161,534
Gjithsej pasuritë		193,613	161,534
DETYRIMET DHE FONDET			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	4	-	4,341
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	193,613	157,193
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		193,613	161,534
Gjithsej detyrimet		193,613	161,534
FONDET			
Suficiti/Deficiti i akumuluar		-	-
Gjithsej fondet		-	-
Gjithsej fondet dhe detyrimet		193,613	161,534


Të aprovuara dhe lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tij më 11 mars 2022.

Zyrtare e financave




Tringa Naka

Drejtori i përgjithshëm



Mentor Vrajolli

Kontabiliste e çertifikuar



Njomza Mujaj

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 11 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

	Shënimi	Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Të hyrat	6	332,809	305,069
Total të hyrat		332,809	305,069
Shpenzimet e personelit	7	(199,674)	(179,374)
Shpenzimet administrative	8	(132,280)	(63,515)
Shpenzimet tjera	9	(855)	(35,618)
Shpenzimet totale		(332,809)	(278,507)
Deficiti/Suficiti neto		-	26,562

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 11 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS

Pasqyra e rrjedhës së parësë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

		Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Rrjedha e parësë nga aktivitet operative			
Suficiti/Deficiti neto		-	26,562
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		-	26,562
Zvogelim në pasuritë e tjera		-	3,600
Zvoglimi në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		(4,341)	(709)
Rritja në detyrimet e tjera		36,420	-
		32,079	29,453
Tatimi në interesi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parësë nga aktivitetet operative		32,079	29,453
Rritja neto e parësë dhe ekuivalentëve të parësë		32,079	29,453
Paraja dhe ekuivalentët e parësë në fillim të vitit	3	161,534	132,081
Paraja dhe ekuivalentët e parësë në fund të vitit	3	193,613	161,534

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 11 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. TË PËRGJITHSHME

"Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë- QKSS " është një organizatë jo-qeveritare me nr të regjistrimit 51118405 e regjistruar pran Ministrisë së Administratës Publike në Kosovë në Prill 2008 si dhe me nr. Fiskal: 600278685. Adresa e regjistruar e zyrës dhe vendi bazë i organizatës është Rr. Rruga Sylejman Vokshi, Blloku B, Hyrja 2, Nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Aktiviteti kryesor i "QKSS " është studimi dhe kërkimi shkencor, organizim të tryezave dhe konferencave në sferën e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes.

Më 31 dhjetor 2021 kompania kishte 14 të punësuar (31 dhjetor 2020, 18 të punësuar).

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë(QKSS) është qendër e pavarur për politika të hulumtimit e themeluar në Prill 2008 në Prishtinë – Kosovë. QKSS është e dedikuar në zhvillimin e sektorit të sigurisë dhe reformave në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ajo në mënyrë aktive promovon parimin e qeverisjes së mirë, integritetin dhe qëndrueshmërinë.

Objektivat Kryesore dhe Qëllimet

E themeluar në 2008, interesi kryesor i QKSS është që të ndihmojë në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, duke u bazuar në qeverisje të mirë. Përreth një dekadë, QKSS ka ndërtuar dhe ofruar ekspertiza alternative në studimet e sigurisë, duke plotësuar një boshllëk në një kontribut të kufizuar akademik në këtë fushë në Kosovë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin duke mbështetur programet RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës. Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave. Gjithashtu, organizon më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, dhe në bashkëpunim me partnerët regjional dhe ndërkombëtar. Një sferë e gjerë e aktiviteteve përfshijnë hulumtimet, ndërtimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe avokimin.

Ekipi i ekspertëve të QKSS është gjithmonë rezilient në zhvillimin e qasjeve të reja dhe ideve për të ofruar përgjigje në sfidat e reja, çështjet kritike dhe kërcënimet ndaj sigurisë, si ekstremizmi i dhunshëm, si një prej kërcënimeve më shqetësuese të sigurisë zhvilluar kohëve të fundit në Kosovë dhe në nivel global. Shumica e rekomandimeve të politikave dhe mundësive janë zhvilluar në bashkëpunim me akterët kryesorë dhe palët e interesuara, si krijuesit e politikave, ekspertët, akademikët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. QKSS ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në procesin e politikave duke ofruar ekspertiza në dokumente të rëndësishme ligjore, strategjive dhe planeve të veprimit në lidhje me zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë.

2. POLITIKAT E KONTABILITETIT

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.2 Baza e matjes

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazat matëse të specifikuara në procedura për çdo lloj të aseteve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përkrahura në politikat e kontabilitetit më poshtë.

2.3 Valuta e paraqitur

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 janar 2002.

2.4 Shkëmbimi i valutës së huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga ri-matjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fund vitit paraqiten si fitim ose humbje. Zërat jo-monetar të matur me kosto historike janë të shkëmbyera duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit (jo të ri shkëmbyera). Zëra jo-monetar të matur me vlerën e drejtë janë shkëmbyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgaditja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF për NVM, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshime nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.6 Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të ardhurave, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon që kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe ti mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.7 Te hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra paraqesin të gjitha pagesat e pranuar nga kontratat/projektet të cilët do të organizohen gjatë vitit të ardhshëm.

2. POLITIKAT E KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.8 Detyrimet në Qira

Një detyrim i qirasë njihet në datën e fillimit të qirasë. Detyrimi i qirasë fillimisht njihet në vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë, duke u zbritur duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shkalla e huazimit në rritje të njësisë së konsoliduar. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse më pak çdo stimulim të arkëtueshëm, pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, shuma që pritet të paguhet nën garancitë e vlerës së mbetjes, cmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje kur ushtrimi i opsionit është i sigurt për të ndodhur, dhe çfarëdo gjobitjeje të parashikuar të përfundimit. Pagesat e qirasë së ndryshueshme që nuk varen nga një indeks ose një normë janë shpenzuar në peridhën në të cilën ato ndodhin.

Detyrimet e qirasë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Vlerat kontabël rivlerësohen nëse ka një ndryshim në vijim: pagesa të ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose një normë e përdorur; garanci e mbetur; afati i qirasë; sigurinë e një opsioni blerjeje dhe gjobat e mbarimit. Kur një detyrim i qirasë është ri-matur, bëhet një rregullim në aktivin korrespondues të së drejtës së përdorimit, ose në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivit të së drejtës së përdorimit është shkruar plotësisht.

Qiradhëniet në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënesi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra nën qiranë operative ngarkohen në fitim ose humbje në baze lineare gjatë periudhës së qirasë.

2.9 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura në banka dhe investime afat-shkurtër me likuidet të lartë që skadojnë brenda periudhës 12 muaj.

2.10 Përfitimet e punëtorëve

Detyrimet pensionale

Kompania ka skemë të pensioneve të përcaktuara nga legjislati vendor i sigurimeve shoqërore, sipas të cilës ajo kontribuon në planin e pas daljes në pension të punëtorëve të saj. Kontributet, bazuar në pagat bruto, janë bërë në planin e pensionit shtetëror, Trusti Pensional i Kosovës (TKPK) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Nuk ka asnjë detyrim shtesë në lidhje me këto plane.

2.11 Njohja e të hyrave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në QKSS dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

2.12 Te pagueshmet tregtare dhe tjera

Të pagueshmet tjera dhe tregtare njihen në vlerën reale dhe më pastaj maten me kostot e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

2.13 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse me shfrytëzimin e shërbimit ose në datën e origjinës së tyre.

2.14 Tatimi në korporata

QKSS është krijuar si Organizatë jo-profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në korporata.

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS
Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Raiffeisen Bank- 1501090000677812	155,806	123,791
Raiffeisen Bank- 1501090003447938	25,011	2,895
Raiffeisen Bank- 1501090002630713	12,768	1,528
Raiffeisen Bank- 1501090003634954	5	33,288
Raiffeisen Bank- 1501090002840524	-	2
Paraja në Arka	23	30
TOTAL	<u>193,613</u>	<u>161,534</u>

4. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Kontribute pensionale	-	2,145
Tatimi i mbajtur ne burim	-	1,830
Llogaritë e pagueshme tregtare	-	366
TOTAL	<u>-</u>	<u>4,341</u>

5. DETYRIMET TJERA AFATSHKURTRA

	Më 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Të hyrat e shtyra	193,613	157,193
TOTAL	<u>193,613</u>	<u>157,193</u>

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS
Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

6. TË HYRAT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
National Endowment For Democracy	132,620	53,161
Glasgow Caledonian University	60,930	-
The German Marshall Fund of the US	56,372	15,728
Fondacioni Kosovar per Shoqeri	25,000	10,000
Gcerf, Fonds Mondial Pour	24,800	-
U.S.Disbursing Officer Symbol	21,770	-
Berghof Foundation Operations GMB	18,225	136,688
European Fondation For South - DRIVE	16,450	-
BCBP	7,750	6,050
International Republican Institut	4,183	6,291
Synyo GMBH	2,353	10,709
Civil Rights	2,000	-
The Global Initiative	500	-
Norsk Utenrikspolitisk Institut	-	8,820
VZW Extremely Eunited	-	25,787
Raiffeisen Bank	-	8
Endowment Of The United S USDO	-	1,636
Canadian Embassy	-	2,138
Balkans Policy Research Group	-	273
Fundacja Instytut Studiow	-	270
Ministrie Van Buitenlandse	-	25,000
Center for the Study of Democracy	-	2,510
Total të hyra bruto	372,953	305,069
Të hyrat e shtyera 2021	(40,144)	-
TOTAL TË HYRAT NETO	332,809	305,069

7. SHPENZIMET E PERSONELIT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Shpenzimet e pagave bruto	190,192	170,875
Kontributet pensionale nga punëdhënësi	9,482	8,499
TOTAL	199,674	179,374

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË- QKSS**Shënimet mbi pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021****8. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE**

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Shpenzimet e ndryshme	69,808	-
Shpenzimet e përkthimeve	12,940	11,166
Shpenzimet e printimit dhe dizajnit	7,954	767
Shpenzimet e qirase	7,912	7,952
Shpenzimet e akomodimit	5,191	5,789
Shpenzimet për salla	4,995	3,866
Shpenzimet për pije dhe ushqim	4,448	4,357
Shpenzimet e Derivateve	3,446	2,763
Shpenzimet e furnizimit për zyre	2,582	2,120
Shpenzimet e udhëtimit lokal	2,462	3,861
Shpenzimet e transportit	2,055	-
Shpenzimet për paisje kompjuterike	1,580	105
Shpenzimet e telefonit	1,394	84
Shpenzimet e kontabilitetit	1,200	1,200
Shpenzimet e udhëtimit - huazim i vetures	1,075	6,185
Shpenzimet e Auditimit	850	850
Shpenzimet e ngrohjes	582	788
Shpenzimet e parkingut	542	98
Shpenzimet e mirëmbajtjes së Automjetit	463	1,186
Shpenzimet e rrymes	186	221
Shpenzimet e interneti	180	240
Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	157	85
Shpenzimet e ujit	118	88
Shpenzimet e mbeturinave	107	185
Shpenzimet e Sigurimit në Udhëtim	24	-
Shpenzimet e postës	15	9
Shpenzimet për tatim në prone	14	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes	-	8,773
Shpenzimet e provizioneve	-	627
Shpenzimet e pastrimit të veturës	-	83
Shpenzimet për viza	-	60
Shpenzimet noteriale	-	7
TOTAL	132,280	63,515

9. SHPENZIMET TJERA

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Shpenzimet e provizioneve bankare	855	-
Shpenzimet tjera	-	35,618
TOTAL	855	35,618

10. ZOTIMET DHE KONTINGJENTET

Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

11. NGJARJET PASUESE

Ngjarjet pas përfundimit të vitit raportues në bilancin e gjendjes, dhe të cilat japin informacione shtesë për pozitën e Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë të rregulluara janë shpalosur në shënimet plotësuese kur ngjarja reflekton vlera materiale.